**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republikc of Kosovo**
**Komunal e Dragash - Opština Dragaš / Dragash Municipality**

**-Kuvendi Komunal**
**01 Nr.06-4240/4**
**Dt.20.03.2014**
**D r a g a sh**

Në bazë të nenit 42.2.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L 040, si dhe të nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit 01 nr.06-103 të dt.11.09.2008 dhe në harmoni me nenin 7.3 të Ligjit nr.04 /L-144 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme Komunale, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e rregullt të dt.20.03.2014, miraton këtë:

# VENDIM

**I.MIRATOHET** Propozimi i kryetarit të komunës-Dragash për publikimin e ankandit publik për dhëninen në shfrytëzim të pjesës së patundshmërisë së Komunës me kriteret vijuese të cilat do t'i zbaton Komisioni Komunal për Vlerësimin dhe dhënine në shfrytëzim të patundshmërisë së Komunës.
Mënyra e dhënies: **/ ankand publik**
Lënda e ankandit publik., pjesa e parcelës kad. : **782 ZK Dragash**
Pozicioni i patundshmëris, vendi: **Dragash, parkingu afer Gjykatës,** në këndin e sipërm të majtë.
Hapësira e parashikuar për ankandin: **12 $m^2$**
Afati i shfrytëzimit: **15 vite**
Kriteret: **çmimi më i lartë i ofruar**
Çmimi fillestar mujor: **1 € për 1 $m^2$**
**Kufizimet:** Në tender-ankand publik mund të marrin pjesë të gjithë personat fizik dhe juridik të profesionit ligjor: noterë, kontabilistë, avokatë, zyret ligjore, zyra e ndihmës juridike, përkthyesit gjyqësor, etj,
**- Lloji i objektit:** kiosk montimi , kiosk nga materiali lehtë PVC ose materiali i kombinuar, nënkupton shtyllat nga betoni ose druri deri në nivelin / e ngritur objektin në lartësin e nivelin të rrugës , përkatësisht të muri rrethues pranë trotarit. Pllaka e komplete statike nga betoni përjashtohet:
- Po ashtu, ky Vendim ka të bëj edhe me kriteriumet tjera dhe kufizimet dhe procedurat e parapara në Prozimin e kryetarit, për çka Komisioni për Vlerësim do të ketë kujdes me rastin e shpalljes së Ankandit Publik,përkatësisht me rastin e formulimit të teksit të Lajmërimit, dhe pas skadimit të afatit do të vepron sipas dispozitave normative.

I dërgohet:
- Zyrës së Prokurimit të komunsë-Dragash,
- Arkivit

**KRYESUESI I KUVENDIT:**
*Shaban Shabani*